



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 363/6 prot

Datë 19.02.2025

V E N D I M

Nr. 262/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.02.2025 u shqyrtua ankesa me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr.REF-34754-12-27-2024, me objekt: *“Blerje tuba per marrjen e kampioneve te gjakut dhe materialeve konsumi per laboratorin Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 24 muaj”*, me fond limit 12,453,265 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 20.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Elbasan.

Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK për skualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Elbasan.
Drejtoria e Spitalit, Elbasan

Ankimues: “Krijon” SHPK me NIPT K12023001A dhe adresë: Rruga e Elbasanit, Nr. 57, Çollak, Tiranë.

“Fedos” SHPK me NIPT K01514009I dhe adresë: Rruga Kujtim Laro -Tirane,Nr pasurie 3/22,Kati 2, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.12.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit *“E hapur”*, me nr.REF-34754-12-27-2024, me objekt: *“Blerje tuba per marrjen e kampioneve te gjakut dhe materialeve konsumi per laboratorin Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 24 muaj”*, me fond limit

12,453,265 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 20.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Elbasan.

II.2. Në datën 27.01.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave. Operatorët ekonomikë ankimues ankimues janë njoftuar elektronikisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik “Krijon” SHPK:

Arsyet e skualifikimit:

“Ne katalog per artikullin nr. 5 vrellimi I kerkuar eshte 1.6-5ml dhe jo me pak sic eshte ofertuar nga Operatori Ekonomik 1.28ml

Ne katalog per artikullin nr. 6 nuk specifikohet nese eshte pediatrike

Ne katalog per artikullin nr. 8 prodhuesi SANGUIS COUNTING YUEKANG MEDICAL APPLIANCE CO., LTD ska Certificate CE kur klasa ne deklaraten e konformitetit eshte percaktuar si IIA.”

Operatori ekonomik “Fedos” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Arsyet e skualifikimit:

“Ne katalog per artikullin nr. 8 opsioni i dyte prodhuesi Becton, Dickinson and Company ska Certificate CE kur klasa ne deklaraten e konformitetit eshte percaktuar si IIA..”

II.3. Në datën 31.01.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e anulimit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.4. Në datën 06.02.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5028, protokolluar me nr.363/2025 prot, datë 07.02.2025, i operatorit ekonomik “Krijon” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Krijon” SHPK.

II.4.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 363/1 prot, datë 10.02.2025 me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Krijon” SHPK kundërshton me anë të ankesës së tij.

II.5. Në datën 06.02.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5029, protokolluar me nr.364/2025 prot, datë 07.02.2025, i operatorit ekonomik “Fedos” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK në këtë procedurë.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 364/1 prot, datë 10.05.2025 me arsyet e skualifikimit të ankimuesit.

II.6. Në datën 12.02.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr 363/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Spitali Rajonal Elbasan nr. 248 prot., datë 10.02.2025 me objekt: “*Vënie në dijeni*”, ndërsa në datën 14.02.2025 është protokolluar në KPP me nr. 363/3 prot., Vendimi i KSHA-së për shqyrtimin e ankesës. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton se ankimuesi nuk ka kryer pagesën e e tarifës përkatëse të ankimit, edhe pas mesazhit të dërguar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, ku bëhet me dije ankimuesi për mangësitë e konstatuara në lidhje me këtë ankesë dhe korrigjiin e tyre brenda 2 ditëve nga njoftimi.

II.7 Në datën 19.02.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr 364/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Spitali Rajonal Elbasan nr. 1988/11 prot., datë 12.02.2025, bashkëngjitur Vendimi i KSHA-së nr. 1988/10 prot., datë 11.02.2025 për shqyrtimin e ankesës. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton se pretendimet e ankimuesit janë pranuar plotësisht nga KSHA.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK, për skualifikimin e tij të padrejtë në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Krijon” SHPK nuk ka bashkëlidhur dokumentin bankar, që të vërtetojë se ka kryer pagesën e tarifës financiare për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me përcaktimet në pikat 2 dhe 4 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III.1.2. Në nenin 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.3. Në pikën 2 gërma “a”, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;”

III.1.4. Në datën 06.02.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5028, protokolluar me nr.363/2025 prot, datë 07.02.2025, i operatorit ekonomik “Krijon” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Krijon” SHPK.

Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik “Krijon” SHPK, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet, se kësaj të fundit i mungon dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

III.1.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b)

të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 363/1 prot, datë 10.02.2025 me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Krijon” SHPK kundërshton me anë të ankesës së tij.

III.1.6. Në datën 12.02.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr 363/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Spitali Rajonal Elbasan nr. 248 prot., datë 10.02.2025 me objekt: “*Vënie në dijeni*”, ndërsa në datën 14.02.2025 është protokolluar në KPP me nr. 363/3 prot., Vendimi i KSHA-së për shqyrtimin e ankesës. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton se ankimesi nuk ka kryer pagesën e tarifës përkatëse të ankimit, edhe pas mesazhit të dërguar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, ku bëhet me dije ankimesi për mangësitë e e konstatuara në lidhje me këtë ankesë dhe korrigjiin e tyre brenda 2 ditëve nga njoftimi. Në Vendimin e KSHA-së argumentohet si vijon:

“[...] Autortieti Kontraktor Spitali Rajonal Elbasan , ka shpallur ne sistemin elektronik te APP-se, ne daten 11.04.2024, proceduren e prokurimit me objekt “Blerje tuba per marrjen e kampioneve te gjakut dhe materialeve konsumi per laboratorin” me REF-34754-12-27-2024 me fond limit 12,453,265 leke pa Tvsh.

Ne date 07.02.2025 ne rruge elektronike Autoriteti Kontraktor njihet me nje ankese te depozituar ne rruge elektronike prane Komisionit te Prokurimit Publik, perkatesishte ankesen me numer aplikimi online A/2025/5028 dhe me nr 363/2025 prot prane KPP.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkelidhur ankeses se operatorit ekonomik “KRIJON” shpk konstatohet se formularit te ankeses i mungon bashkelidhur dokumenti bankar qe verteton kryrjen e pageses se tarifes perkatese per ankesen e paraqitur.

Sa me siper, Ligji 162/2020 “Per Prokurimin Publik” Neni 111, pikat 2 dhe 4 parashikon shprehimisht se:

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, km shënoheri emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankeses, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat perkatese, per të cilat mendon se mbeshtesin ankimin e tyre. Elementet e siperpermendur jane te domosdoshme per shqyrtimin e ankeses. Ankimesi eshte i detyruar t'i bashkelidhe ankimit dokumenin bankar që vërteton pagesën e tarifës perkatese per ankesen.

4. Ne cdo rast, paraqitja e ankeses shoqerohet me mandatpagesën e bere pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Ne rastin konkret ankimesi eshte i detyriar ti bashkelidhe dokumentin bankar qe verteton pagesen e tarifes perkatese, element i cili eshte shume i rendesishem per marrjen ne shqyrtim te ankeses. Gjithashtu nga verifikimet e kryera ne sistem edhe ne faqen zyrtare te KPP statusi i mandat pageses per kete procedure rezulton i papaguar/ i paparaqitur.

Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Elbasan per vijimin e hapave te metejshem dhe per marrjen ne shqyrtim te ankeses e ka te domosdoshme respektimin e te gjithë kushteve dhe elementeve te parashikuar ne Ligjin 162/2020 “Per Prokurimin Publik” Neni 111 dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Per Prokurimin Publik” neni 94 per menyren e paraqitjes se ankesave.

Mbeshtetur ne parashikimet e Nenit 111 pika 3 ne te cilin citohet: Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

Referuar sa me sipër AK i drejtohet Operatorit ekonomik “KRIJON” shpk me shkresen nr 248 Prot date 10.02.2025 dhe me nje mesazh ne sistemin elektronik te ankesave, ku i ben me dije te gjitha mangesite e konstatuara ne lidhje me menyren e paraqitjes se ankeses. Nga ana e operatorit ekonomik nuk pati asnje reagim apo marje masash per rregullimin/korigjimin e elementeve te munguar te ankeses ne fjale dhe asnje kthim pergjigje kundrejt Autoritetit Kontraktor.

Ne keto kushte ne Ligjin 162/2020 “Per Prokurimin Publik” Nenit 111 pika 3, Autoriteti Kontraktor e vlereson ankesen si te paparaqitur”.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi informacionin e dhënë nga ana e autoritetit kontraktor Spitali Rajonal Elbasan, nga ku rezultoi se në datën 11.02.2025 i është dërguar mesazh operatorit ekonomik “Krijon” SHPK, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave. Me anë të këtij mesazhi njoftohet ankimuesi për mangësitë e konstatuara në ankesën e tij elektronike nr. A/2025/5028, lidhur me mungesën e pagesës së tarifës së ankimit. Konkretisht rezulton se është dërguar mesazhi i mëposhtëm:

Appeal	A/2025/5028	Veprimi	Kërkoni mandat pagesën
Krijuar nga	K52905226H - Qendra Spitalore Xhaferri Kongoli Elbasan		
Mesazhi	Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkelidhur ankeses se operatorit ekonomik "KRIJON" shpk konstatohet se formularit te ankeses i mungon bashkelidhur dokumenti bankar qe verteton kryjen e pageses se tarifës perkatese per ankesen e paraqitur.		
Dërguar në e-Albania	☐		

MBYLL

III.1.8. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elementë të domosdoshëm formalë për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshëm për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë, se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk çënon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni

ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë, për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP, rezulton, se autoriteti kontraktor ka dhënë informacion lidhur me përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, për respektimin e hapave proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor, konstaton, se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën për moskorrigjim të një prej elementëve formale të domosdoshëm siç është pagimi i tarifës së ankesës.

Pra në kushtet kur ankimesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës, edhe pas njoftimit të bërë nga autoriteti kontraktor, si më sipër cituar, Komisioni gjykon, se ankesa e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK, nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar në gërmën “a” të pikës 2, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kjo ankesë duhet refuzuar.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK, për skualifikimin e tij të padrejtë në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Referuar vendimit të KSHA-së nr. 1988/10 prot., datë 11.02.2025 mbi ankesën e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK, bashkëngjitur shkresës së autoritetit kontraktor me nr. 1988/11 prot., datë 12.02.2025, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 364/2 prot., datë 19.02.2025 rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimesi.

III.2.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se:

Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.2.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ të pretendimeve që nuk janë pranuar;;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në kushtet kur operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mbyllë çështjen, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr.REF-34754-12-27-2024, me objekt: “Blerje tuba per marrjen e kampioneve te gjakut dhe materialeve konsumi per laboratorin Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 24 muaj”, me fond limit 12,453,265 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 20.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Elbasan.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të

Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK për procedurën e “E hapur”, me nr.REF-34754-12-27-2024, me objekt: “Blerje tuba per marrjen e kampioneve te gjakut dhe materialeve konsumi per laboratorin Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 24 muaj”, me fond limit 12,453,265 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 20.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Elbasan
 2. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK për skualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

